

THIRRJE PËR APLIKIM NË TRAJNIME PËR AFTËSIM PROFESIONAL

Projekti: Aktivitetet për Gjenerimin e të Ardhurave

RRETH PROJEKTIT:

Foundation Kosovo-Luxembourg është duke zbatuar projektin për "Gjenerimin e të Ardhurave " projekt ky që ka për qëllim dhënie e asistencës teknike për të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë dhe Kllokotit që synojnë të vet-punësohen dhe të përgatiten për tregun e punës.

KUSH MUND TË APLIKOJË:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë dhe Kllokotit të moshës **18 – 50 vjeç**.

QËLLIMI I THIRRJES:

Thirrje për Aplikim për Trajnime Profesionale në këto drejtime:

- **Rrobaqepësi**
- **Elektro instalues**
- **Ngrohje qendrore dhe ujësjellës**
- **Kuzhinieri**
- **Salldues metalesh**

SI TË APLIKOHET?

- **Të gjithë kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë dhe sjellin këto dokumente:**

- Formulari për Aplikim
- Kopje e letërnjoftimit

Formulari për Aplikim mund të merret pranë Zyrës për Investime në Komunën e Vitisë (afër Drejtorisë së Bujqësisë), kurse në Komunën e Kllokotit tek drejtorja e Bujqësisë

DATA E FUNDIT PËR APLIKIM DHE DORËZIM TË APLIKACIONIT:

- Faza e aplikimit hapet që nga data **22 Mars 2021**
- Data e fundit për aplikim është me **19 Prill 2021**

Formulari i plotësuar së bashku me dokumente të tjera për aplikim mund të dorëzohen në Zyrën për Investime në Komunën e Vitisë kurse në Kllokot tek drejtorja e Bujqësisë

Të gjitha shpenzimet e trajnimit do të mbulohen nga Foundation Kosovo-Luxembourg.